

AKT THEMELIMI
I SHOQERISË ME PERGJEGJËSI TË KUFIZUAR
SHOQERIA "SNET-KS LLC "

Në Lezhë, sot më 02.04.2024 themelojme shoqerine **SNET-KS LLC** shpk, sipas kërkesave të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" nr. 9901 date 14.04.2008, si dhe ligjin nr 9723 date 03.05.2007 " Për Qendrën Kombëtare të Biznesit " , si me poshtë:

THEMELUESI:

Z. SHABAN HYSENI me atësi Kulusin, amesi Hidajete i datelindjes 02.04.1988, lindur dhe banues në Prishtinë, Kosovë, shtetas Kosovë, madhor dhe me zotësi të plote juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit nr. ID1219013 dhe me nr. personal 1251035462.

NENI 1

Te krijoj shoqërinë tregtare me formë ligjore "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" me emërtim tregtar të shoqërisë **"SNET-KS LLC"** e cila do të vepronte në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, dispozitat e kësaj kontrate, me statutin bashkëngjitur kësaj kontrate, me ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" nr 9901 date 14.04.2008 dhe formalitetet që duhen plotësuar në të.

NENI 2

Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: Lezhë, Lezhë, Shënkoll, Tale, z.k. 8136, numri i pasurisë 21/5.

NENI 3

Shoqëria do të ketë për objekt të veprimtarisë të saj ushtrimin e aktivitetit në fushën e : **IT shërbime outsourcing** dhe do të ushtrojë veprimtarinë e saj private për një periudhë kohore të pacaktuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi

NENI 4

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin, vendqëndrimin, selinë, kohëzgjatjen, pjesëmarrjen e kuotave, objektin e veprimtarisë së saj, me vendim të ortakeve sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë: **100.000 (nëqind mijë) leke** e përbërë nga 1 (një) kuota që i përket ortakakut të vetëm si më poshtë.

1. - Shaban Hyseni = me 100 % të kapitalit = 1 kuota = 100,000 leke

Çdo kuota i takon e drejta e një vote.

NENI 6

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimeve që do të marre ortakut, por në asnjë rast njeri ortak nuk mund të detyrojë ortakët e tjerë të rrisin kuotën e tyre në kapitalin e shoqërisë.

Në rast se kapitali i shoqërisë për shkak të humbjeve të vërtetuara në dokumentet financiare, rezulton me i vogël se gjysma e kapitalit themeltar, ortakët vendosin brenda tre muajve nga miratimi i llogarive të përcaktojnë këtë humbje mbi mundësinë e prishjes së parakohshme të shoqërisë. Në rast se prishja nuk shpallet, shoqëria zvogëlon kapitalin e saj me një vlerë jo më të vogël se ajo e humbjeve që kanë mbetur, pa mbuluar fondet rezerve.

NENI 7

Ortakut që ka ndërmend t'u shesë të tretëve kuota të kapitalit të tij, tërësisht apo pjesërisht, duhet të njoftojë me parë ortakët e tjerë të shoqërisë, të cilët kanë të drejtën e parablerjes qofte dhe në kushte të barabarta. Kjo e drejtë duhet ushtruar brenda 30 ditëve nga data e komunikimit. Për hollësi të mëtejshme ortakët do të referohen dispozitave të parashikuara në Ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" nr. 9901 datë 14.04.2008.

NENI 8

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e ortakëve;
- Administratori

Procedura për emërimin në funksionet përkatëse dhe shkarkimin e tyre rregullohen sipas statutit të shoqërisë.

NENI 9

Administrator emërohet **SHABAN HYSENI** me atësi Kulusin, amesi Hidajete i datelindjes 02.04.1988, lindur dhe banues në Prishtinë, Kosovë, shtetas Kosovar, madhor dhe me zotësi të plote juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit nr. ID1219013 dhe me nr. personal 1251035462.

Administratori zgjidhet për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritjeje.

NENI 10

Vendimet e Asamblesë janë të vlefshme nëse janë miratuar nga ortakët e saj sipas dispozitave të Ligjit Për Shoqëritë Tregtare në lidhje me pjesëmarrjen dhe shumicën e votave sipas kuotave në kapitalin themeltar për Asamblesë dhe Zakonshme dhe të Jashtëzakonshme. Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Zakonshme dhe të Jashtëzakonshme, kompetencave të ortakëve dhe marrjes së vendimeve do të bazohet në statutin e shoqërisë si dhe në Ligjin "Për shoqëritë tregtare".

NENI 11

Likuiditet dhe transaksionet financiare do të depozitohen në bankat shqiptare dhe në ato të huaja, ku shoqëria ka llogarite e saj rrjedhëse.

Për kapitalin themeltar të shoqërisë është hapur libri i llogarive ku do të shënohet kontributi i ortakut të vetëm. Po kështu shoqëria ka dhe përdor dokumentacionin sipas kërkesave të ligjit për kontabilitetin si dhe gjithë kërkesave të tjera financiare, të domosdoshme për veprimtarinë normale të saj.

NENI 12

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria do te ndahet ndërmjet ortakeve mbasi te jene likuiduar te gjitha detyrimet, dhe te jete hequr 5% qe do te futet ne fondin e rezervës ligjore deri ne përmbushjen e 1/10 te kapitalit te shoqërisë.

NENI 13

Shoqëria fillon veprimtarinë e saj vetëm pasi te ketë marre autorizimin e organeve kompetente sipas legjislacionit ne fuqi.

Ky akt themelimi u përpilua ne katër dokumente origjinale me fuqi te barabarte secila.

THEMELUESI DHE ORTAK I VTEM I SHOQERISE

1. Shaban Hyseni

